



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) dhe në lidhje me nenin 35, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 123, paragrafi (7) dhe neni 184, paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për përmbajtjen, mënyrën, formën dhe afatet e dorëzimit dhe të publikimit të të dhënave dhe informacioneve për statistikat pagesore

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton përmbajtjen, mënyrën, formën dhe afatet që ofruesit e shërbimeve pagesore dhe operatorët e sistemit pagesor, janë të detyruar t'i zbatojnë gjatë dorëzimit të të dhënave dhe/ose informacioneve për statistikat pagesore në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) dhe afatet për shpalljen e tyre nga Banka Popullore.
2. Disa shprehje të përdorura në këtë vendim kanë kuptimin si në vijim:
 - 2.1. "Raportues" janë:
 - ofruesit e shërbimeve pagesore nga neni 9, paragrafi (1), pikat 1), 2), 3), 4), 5) dhe 7) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe
 - operatorët e sistemeve pagesore, të përcaktuara në nenin 133, paragrafi (1), pika 7) të Ligjit.
 - 2.2. "Të dhënat dhe informacionet mbi statistikat pagesore" ose "statistikat pagesore", janë të dhëna dhe informacione që lidhen me llogaritë pagesore, llojin, vëllimin dhe tarifat për transaksionet pagesore të kryera, shërbimet pagesore, instrumentet pagesore, shumën e tarifës së shërbimit të shitësit, tarifën e shkëmbimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve pagesore dhe tarifën për skemën pagesore me kartelë në transaksionet pagesore të bazuara në kartela, të cilat Banka Popullore i mbledh dhe i përpunon për qëllime statistikore me qëllim mbikëqyrjen e përdorimit të shërbimeve pagesore dhe zhvillimin e sistemit pagesor në vend.

II. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

3. Njoftuesit nga pika 2), nënpika 2.1.), paragrafi (1) të këtij vendimi, janë të detyruar që në mënyrë të saktë dhe të plotë t'i dorëzojnë Bankës Popullore të dhënat dhe informatat për statistikat pagesore për:
 - 3.1. Llogaritë:
 - numri i llogarive pagesore, llogaritë pagesore me funksion bazë, llogarive pagesore ku ruhen paratë elektronike, llogarive të bllokuara pagesore dhe bllokimet sipas bazës;

- numri i llogarive pagesore sipas strukturës së moshës dhe gjinisë dhe komunave;
- numri i përdoruesve të shërbimeve pagesore, duke përfshirë përdoruesit aktivë, të cilët kanë qasje në llogaritë pagesore ndërmjet kërkuesit në internet dhe/ose aplikacionit sipas strukturës së moshës dhe gjinisë dhe komunave;
- numri dhe statusi i llogarive joaktive, dhe
- gjendja e parave elektronike të përdorura të emetuara.

3.2. Kartelat pagesore të lëshuara në vend:

- numri i kartelave pagesore sipas: funksionit të kartelës, markës së kartelës, teknologjisë së inicimit të transaksioneve pagesore të bazuara në kartela dhe komunave.

3.3. Pajisjet që pranojnë kartela pagesore:

- numri i pajisjeve që pranojnë kartela pagesore;
- numri i shitësve dhe pikave të shitjes në vend, përfshirë edhe shitësit aktivë dhe pikat aktive të shitjes, ku janë instaluar pajisje që pranojnë kartela pagesore;
- numri i filialeve, agjentëve, bankomatëve dhe pajisjeve në pikat fizike të shitjes sipas komunave, dhe
- emërtimi i shërbimeve publike dhe institucioneve shtetërore ku janë instaluar pajisjet që pranojnë kartela pagesore.

3.4. Transaksionet pagesore sipas llojit të shërbimeve pagesore:

- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore sipas llojit të shërbimeve pagesore;
- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore në bazë të kartelave sipas vendeve në të cilat janë kryer;
- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore me kartelë sipas strukturës së moshës, dhe
- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore të inicuar me mashtrim sipas llojit të shërbimeve pagesore.

3.5 Transaksionet pagesore sipas llojit të pajisjes që pranon kartela pagesore:

- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore sipas pajisjeve që pranojnë kartelat pagesore, vendeve në të cilat janë kryer transaksionet pagesore dhe markës pagesore të kartelave pagesore.

3.6 Tarifat:

- tarifat e shërbimit të shitësit;
- tarifat që mbajtësi i kartelës pagesore i paguan ofruesit të shërbimeve pagesore dhe
- tarifë shkëmbimi ndërmjet ofruesve të shërbimeve pagesore dhe tarifë të skemës së pagesave me kartelë në transaksionet pagesore të bazuara në kartela.

4. Raportuesit nga pika 2), nënpika 2.1.), paragrafi (2) i këtij vendimi janë të detyruar që në Bankën Popullore t'i dorëzojnë të dhënat për statistikat pagesore për:

4.1 Pjesëmarrësit e sistemeve pagesore:

- numri i pjesëmarrësve në sistemin pagesor, duke përfshirë ndarjen e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

4.2 Transaksionet pagesore të përpunuara ndërmjet sistemeve pagesore:

- numri dhe vlera e transaksioneve pagesore të përpunuara ndërmjet sistemit pagesor të njehershme në vend, sipas llojit të shërbimit pagesore.

III. MËNYRA, FORMA DHE AFATET E DORËZIMIT TË TË DHËNAVE

5. Raportuesit janë të detyruar që të dhënat nga pika 3) dhe 4) të këtij vendimi t'i dorëzojnë Bankës Popullore në mënyrë elektronike, në pajtim me aktin nënligjor që rregullon lidhjen me sistemin informativ të Bankës Popullore.
6. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat nga pika 3) nënpika 3.1), nënparagrafet (1), (4) dhe (5), nënpika 3.2), përveç sipas komunave, nënpika 3.3), nënparagrafi (1), nënpika 3.4), nënparagrafet (1) dhe (2), nënpika 3.5) dhe pika 4) nga ky vendim, në baza tremujore, për çdo muaj të tremujorit raportues, jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë e punës e muajit të parë të tremujorit rrjedhës, për tremujorin paraardhës.
7. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat nga pika 3) nënpika 3.1), nënparagrafet (2) dhe (3), nënpika 3.2), vetëm sipas komunave, nënpika 3.3), nënparagrafet (2), (3) dhe (4), nënpika 3.4), nënparagrafet (3) dhe (4), dhe nënpika 3.6) nga ky vendim, në baza vjetore, jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë e punës e janarit, për vitin paraardhës.
8. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat nga pika 3) nënpika 3.1), nënparagrafet (2) dhe (3) dhe nënpika 3.2), nga ky vendim sipas komunave, e cila përcaktohet nga adresa zyrtare e banimit të personit të cilit i referohen të dhënat e raportuara.
9. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat nga pika 3) nënpika 3.4) nënparagrafi (2) dhe nënpika 3.5), të këtij vendimi sipas vendeve individuale në të cilat janë kryer transaksionet pagesore.

IV. PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

10. Banka Popullore i publikon të dhënat në formë të përmbledhur, në faqen e saj të internetit, çdo tremujor, respektivisht çdo vit, në pajtim me kalendarin e publikimit të të dhënave dhe informacioneve për statistikat pagesore, me përjashtim të të dhënave nga pika 3), nënpika 3.1) nënparagrafi (3) dhe (4), nënpika 3.3) nënparagrafi (4) dhe nënpika 3.6) nënparagrafi (2) dhe (3), të cilat do të përdoren vetëm për qëllime analitike dhe nuk do të jenë objekt publikimi.
11. Banka Popullore do të fillojë me publikimin e të dhënave nga pika 3), nënpika 3.1), nënparagrafi (2) dhe nënpika 3.2) të këtij vendimi, të cilat i referohen ndarjes sipas komunave, nga periudha raportuese që fillon nga viti 2024.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

12. Guvernatori i Bankës Popullore me udhëzim rregullon më hollësisht paraqitjen e të dhënave dhe informacioneve për statistikat pagesore nga pikat 3) dhe 4) të këtij vendimi.

Udhëzimi nga paragrafi (1) i kësaj pike do të miratohet më së voni në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

13. Me përjashtim nga pika 8) e këtij vendimi dhe nëse raportuesi nuk ka adresën zyrtare të banimit të personit të cilit i referohen të dhënat e raportuara, raporton për komunën ku bën pjesë filiali i raportuesit ku mbahen llogaritë pagesore, respektivisht kartelat pagesore dhe njofton personin për nevojën e përditësimit të të dhënave sipas adresës zyrtare të vendbanimit, jo më vonë se data 31.12.2023. Për ata persona që nuk kanë përditësuar të dhënat në lidhje me adresën zyrtare të vendbanimit brenda afatit të caktuar, raportuesit janë të detyruar të paraqesin të dhëna për komunën së cilës i përket filiali i raportuesit, ku janë llogaritë pagesore, respektivisht kartelat pagesore të këtyre personave.

14. Raportuesit do të dorëzojnë për herë të parë të dhënat dhe informacionin e paraqitur në baza tremujore, në pajtim me këtë vendim për tremujorin e parë të vitit 2023.

Raportuesit do të dorëzojnë të dhënat dhe informacionin e raportuar në baza tremujore, ndërsa kanë lidhje me tremujorin e katërt të vitit 2022, si dhe të dhënat dhe informacionin vjetor të raportuar për vitin 2022, në pajtim me Vendimin për dorëzimin dhe publikimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21).

Raportuesit do të dorëzojnë për herë të parë të dhënat dhe informacionet që i referohen pikës 3), nënpikës 3.1), nënparagrafi (1) për llogaritë pagesore me funksione bazë dhe nënparagrafit (4), në janar 2024, në pajtim me pikën 6) të këtij vendimi dhe ato do t'i referohen vitit 2023.

Raportuesit do të dorëzojnë për herë të parë të dhënat dhe informacionet që i referohen pikës 3), nënpikës 3.4) nënparagrafi (4) dhe nënpika 3.6) nënparagrafi 3, në vitin 2024, në pajtim me pikën 7) të këtij vendimi dhe ato do t'i referohen vitit 2023.

Me përjashtim të pikave 1) dhe 2) të kësaj pike, raportuesit që kanë marrë licencën për të ofruar shërbime pagesore, për emetimin e parave elektronike ose për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të sistemit pagesor pas datës 1 janar 2023, dorëzojnë të dhënat dhe informacionin nga dita e marrjes së licencës dhe në pajtueshmëri me këtë vendim.

15. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlejture Vendimi për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21).

16. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/XXII-13/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së
Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска